

Trapedan **ÇETO PICARI**

BOTIMET
TOENA
TIRANE

ODHISE K. GRILLO



Kapedan Çelo Picari

Ilustrimet nga:
VEHAP KOKALARI



BOTIMET TOENA
TIRANË 1999

CITTA' di CHIERI
CONSIGLIERE COMUNALE
Vincenzo Cucci

Xhelil Bega i vogël, pesëvjeçar, i cili më vonë do të njihej e do të linte nam me emrin Çelo Picari, ishte shtrirë barkas afër sofrës dhe diçka po vizatonte mbi një copë letër kartëshoreje apo fletoreje siç i themi sot. Mbi kokën e tij qëndroi i ati dhe ndjeu një gëzim në shpirt, prandaj i tha të birit:

- Do të bëhesh zograf, o Xhelili im...

- Jo, o tatë, nuk dua të merrem më vizatime. Unë dua të bëhem trim si ti dhe gjyshi. A nuk e sheh që këtu kam vizatuar një pisqollë?

- Trimërinë na e heq dera, o bir, - pëshpëriti i ati, - ashtu si gjithë picarasve e shqiptarëve.

- Kam vizatuar edhe shpata, edhe pushkë, o tatë, se më pëlqejnë shumë...

Dhe nuk kaluan as dy-tre vjet kur Xhelili shkoi në shtëpi me një pushkë të ndërtuar prej dru shtogu, që mbushej e shtinte me kokrra dëllinje, të cilën e kishte sajuar vetë.

- Dorëzohu, i tha të atit, - se kjo nuk të vret, po ama sytë t'i nxjerr.

- Ruaji saçmet prej dëllinje, që të qorros osmanët, o bir, - i tha i ati duke buzëqeshur.

- Për osmanët do të ruaj plumbat dhe saçmat e vërteta, - iu përgjigj Xhelili dhe doli me vrap për të luajtur me shokët.





Kaluan dhe pak vjet dhe i ati e çoi Çelon e vogël te miqtë e vet në Gjirokastrë, në familjen Topulli, pasi kishte frikë mos ia vrisnin armiqtë e tyre, për hakmarrje, se Mehmeti kishte rënë në gjak me një fis picaras.

Aty jo vetëm hodhi shtat, u selit e mësoi shumë gjëra, që as i kishte parë e as i kishte dëgjuar në Picar, po ia mori dorën edhe thikës e shpatës, revolverit e pushkës, aq sa s'guxonte t'i dilte përpara asnjë versnik e asnjë armik. Këtë e provuan mbi kokën e tyre disa njerëz që shkuan në Gjirokastrë ta vrisnin tinës, dhe e pësuan nga pushka e trimëria e Çelos.



Nuk i kishte mbushur ende të njëzetedy vjetët, kur në luftimet rreth Tepelenës, të pushtuar nga osmanët, Çeloja la nam duke udhëhequr luftëtarët shqiptarë, duke e çliruar qytetin e duke fituar edhe miqësinë e Ali Pashë Tepelenës, i cili më vonë do ta thërriste në oborrin e vet, në Janinë.

Kur shkoi në Janinë, për ta provuar sa trim ishte, Ali Pasha i përgatiti një kurth të vogël: përplasi duart fort e fort dhe disa roja të tij iu vërsulën nga të katër anët Çelos, për ta kapur në befasi, mirëpo ai s'pyeti fare po eci drejt pa iu dredhur asnjë muskul, nxori shpatën nga milli dhe u bë gati për t'u ndeshur. Atë çast Ali Pasha thirri me të madhe:

- Ky trim bën për mua!

Dhe qysh atë ditë Xhelil Bega u pagëzua me emrin Çelo Picari.¹⁾

Ali Pasha e bëri si birin e vet dhe Çeloja u bashkua e u trimërua me burra që bënë emër, si Marko Boçari i Sulit e arvanitët kapedanë Odhise Andruçi, Thanas Dhjakoja etj.



1) Çelo – çelë, d.m.th. trim mbi trima. Shih "Historia e Skënderbeut" të N. Frashërit, ku fjala çelë përdoret disa herë si: "Ishte çelë e trimërisë".



Pas rënies së Ali Pashë Tepelenës, Çeloja me trimat e vet u kthye në Picar dhe puna e parë që bëri ishte vrasja e puthakëmbësit të pushtuesve osmanë, Koçi Gramos. Po në ato ditë Çeloja mori letër nga udhëheqësi i popullit grek në luftën për liri, Ipsilanti, i cili i bënte thirrje të bashkonin armët kundër Perandorisë Osmane. Çeloja përgjigjen ia ktheu duke u sulur kundër taborreve osmane anembanë Kurveleshit, së bashku me shumë kapedanë të tjerë.

Kur në qytetin e Manastirit, osmanët futën në grackë dhe shkuan në thikë e në shpatë shumë e shumë kapedanë shqiptarë, Çeloja me disa shokë të vet nuk shkuan e nuk ra në kurth, po të nesërmen, në shenjë hakmarrjeje i vunë zjarrin një lagjeje të Janinës, ku banonin oficerët madhorë osmanë.



Pak ditë më vonë i bënë pritë dhe vranë Tartarin, korierin perandorak, i cili po çonte në tepsi kokat e kapedanëve shqiptarë Veliko Jaçes e Asllan Kuces, dhe një thes me florinj. Dhe ia dërgoi tepsinë sulltanit me kokën e Tartarit dhe të trimave të tij.



Ndërkohë Çeloja ishte burrëruar e ishte bërë çelë i vërtetë dhe kishte fituar dashurinë e bujarinë e popullit dhe urrejtjen e pushtuesve. Pa kishte lënë një palë mustaqe të mëdha, të cilat, siç thonë disa, i kishte aq të gjata sa i lidhte pas kokës si bishtalecë. Dhe sot e gjeje në Kurvelesh duke thyer forcat osmane, nesër në Delvinë ku mbronte nga pushtuesit e bejlerët bashkëfshatarët e vet, të cilët, nga varfëria e madhe kishin zbritur fushave për një dorë misër dhe pasnesër shkonte në Gjirokastër e vriste pashallarët osmanë Tahsin Efendi e Hasan Bej.

Kaluan ditë dhe një ekspeditë e drejtuar nga Emin Pashai u vu në mes nga trimat e Çelos e të Zenel Gjolekës nga Kurveleshi, të Rrapo Hekalit nga Mallakastra e të Tafil Buzit nga Berati dhe s'mbeti këmbë osmani i gjallë. Pastaj, hipur përmbi kuajt që i ngisnin si veri, të gjithë tok iu drejtuan Beratit dhe rrethuan kalanë. Aty e shtrënguan darën aq fort sa Emin Pashai ngriti flamurin e bardhë e osmanët u dorëzuan, ndërsa pashai vetë iku nëpër natë si hajdut dhe mëngjesi e zuri të fshehur nëpër bodrumet e Kavajës, te miqtë e vet.





Pas shkatërrimit të Emin Pashait, sulltani dërgoi një tjetër ekspeditë ndëshkimore me në krye Daut Pashën, të cilën e pritën në armë Vlora, Tepelena, Skrapari, Tomorrica, Mallakastër e Dëshnica. Në Kurvelesh Çelo Picari i futi në një grykë forcat osmane dhe u ra nga para, prapa, ijas e nga lart duke rrokullisur mbi ta gurë e shkëmbenj, të cilat i kishin përgatitur që më përpara në barrierat me trarë e degë pemësh. Kështu në Stamboll nuk u kthye gjallë asnjë nizam për be.



Kjo e detyroi sulltanin të pranonte gjashtë kërkesat e Çelos e të dhjetra kapedanëve të tjerë shqiptarë për të bërë një amnisti, për të krijuar një administratë për krahinat kryengritëse etj. Vetë sulltani e thirri Çelon në Stamboll dhe, me që nuk ia mbushi dot mendjen për të dorëzuar armët, e futi në burg dhe më vonë e internoi në Konjë të Anadollit.



Po edhe prej Konjës Çeloja drejtonte kryengritësit, me letra e me korierë dhe kjo u jepte zemër luftëtarëve të lirisë...

Një ditë nga ditët Çeloja u arratis nga kampi, i hipi anijes dhe u kthye në vendlindje ku e pritën me nderime të mëdha. Sulltani dërgoi sa e sa zaptie e spiunë, të veshur si haxhilerë e baballarë teqeje që ta gjenin gjallë a vdekur dhe t'ia çonin në Stamboll. Po në vend që të kapnin Çelon, të cilin e ruante populli, Sulltanit i vajtën në sini sa e sa koka të prera osmanësh spiunë...

Dhe prapë Çelo Pëcar u gjetta e u kërkua në fshatin e lindjes, ku nisi përsejt luftën kundër pushtimit osmanë. Kështu që doja të bëja një libër e ai nuk e pranoi... shtoi në libër të fshatit, sikur të kishte me vete...

Osmanët kërko e Çeloja bridh anembanë, në mal e në fushë, fshat më fshat e derë më derë, duke shtuar radhët e luftëtarëve e duke u ndeshur me ekspeditat ndëshkuese. Po një ditë e kapën me tradhëti dhe e internuan prapë në Konjë.



Iljaz

Dhe prapë Çelo Picari u arratis e u kthye në fshatin e lindjes, ku nisi përsëri luftën kundër pushtuesve osmanë. Si nuk iu lodh dora një herë e si nuk e preku dot armiku as me majën e jataganit, sikur të kishte me vete drurin e shenjtë, tek i cili të vjetrit besonin se të bënte të pavdekshëm...



Një herë Çeloja u ndesh ballëpërballë me valiun e Janinës, i cili donte ta bindte e ta bënte për vete, duke i thënë se shqiptarët ishin të paktë në numër, kurse Turqia ishte e madhe dhe e fortë, kështu që s'kishin çfarë t'i bënin. Çeloja, që ishte i luftës, i punës e i shkollës, i gishtit e i penës, i pushkës e i gojës, që e kishte posi shpatë, ia përplasi në turi pashait dhe i tha ato fjalë që populli i ktheu në vargje të cilët kanë mbetur lapidar:

Numërimin Shqipëria
e përdor për bagëtinë
edhe jo për trimërinë!




Vërtet betejat e luftërat e lidhën
me kapedanë e burra trima, po Çelon
e lidhën atdheu, liria e pavarësia edhe
me njerëz të ditur e atdhetarë të



shquar, si Abdyl
Frashëri, me të cilin
pati miqësi të
përjetëshme,
prandaj pranë
revolverit mbante
edhe librin në gji...,
prandaj ishte edhe
trim edhe i ditur si
filozof.

Kaluan ditë, muaj e vjetë dhe Çelon e kapën prapë me tradhëti, por rrugës për në Stamboll e liruan shokët e tij kryengritës. Mirëpo, në pamundësi për t'u kthyer në atdhe mbeti në Greqi, ku luftoi krahpërkrah me popullin grek për liri e pavarësi, në krye të trimave që kishte me vete dhe të vëllezërve arbër, që banonin në Greqi, e që atje i thërrasin edhe sot e gjithë ditën arvanitë... Atje luftoi me mish e me shpirt dhe bëri emër të madh, ashtu siç kishte bërë edhe në atdheun e tij. Mirëpo shovinistët, si shpërblim e futën në burg dhe e helmuan kapedanin plak, i cili luftoi për lirinë e Shqipërisë e të Greqisë. Po shqiptarët e grekët nuk e harruan kurrë Çelo Picarin dhe nuk do ta harrojnë kurrë heroin që kalonte krenar nëpër rrugët e Athinës, i veshur e i mbathur me opinga, tirqe, fustanellë e feste të bardhë dhe me mustaqet e thinjura që i shkonin nga një vesh te tjetri e për të cilat të gjithë betoheshin, duke thënë "Për mustaqet e Çelo Picarit!" Prandaj përmbi varrin e tij shqiptarë, arvanitë e grekë bashkë skalitën me shkronja ari këto fjalë:

"O udhëtarë! Mos u trembni prej vdekjes. Bota u takon trimave, që luftojnë për atdheun!"



LEGJENDA SHQIPTARE - 7
libra të ilustruar për fëmijë

KAPEDAN ÇELO PICARI

Autor: Odhise Grillo

Piktor: Vehap Kokalari

Përkujdesja grafike: Irena Toçi

Janë në qarkullim nga e njëjta kolanë:

SKËNDERBEU

BESA E SHQIPTARIT

DY BATOT DHE ZANA E ILIRISË

TRIM MBI TRÏMA, GJERGJ ELEZ ALIA!

MARO KONDA, TRIMËRESHË!

PRITE, PRITE AZEM GALICËN!

KAPEDAN ÇELO PICARI

LEGJENDA E NJË SHKËMBI

OSO KUKA NË KULLË T'BAROTIT

KOSTANDINI DHE DHOQINA

ZANAT E MALIT DHE FUQIA E MUJIT

KALAJA E ROZAFATIT

NËNA ME ZEMËR TË MADHE